

(Emërtimi i programit të studimit) BACHELOR NË ADMINISTRIM PUBLIK

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë Bachelor në Administrim Publik
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me VENDIM Nr.41, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i parë i studimeve
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik , Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimi	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njehësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit **Bachelor në Administrim Publik** është të aftësojë studentët në zgjidhjen e problemeve në fushat e Administrimit Publik. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit :

1. Të kenë njohuritë e nevojshme për formimin e tyre në teoritë dhe praktikat bazë të administrimit publik dhe menaxhimit të sektorit publik.
2. Të jenë në gjendje të analizojnë dhe interpretojnë politika publike në nivele të ndryshme të qeverisjes.

3. Të zhvillojnë aftësi të mira komunikuese dhe bashkëpunimi në mjedise institucionale dhe ndërdisiplinore.
4. Të kuptojnë parimet e etikës dhe transparencës në administratën publike.
5. Të jenë të aftë të përdorin teknologji bashkëkohore dhe mjete kërkimore për të përmirësuar efikasitetin institucional.
6. Të jenë të përgatitur për të vazhduar studimet në ciklin e dytë ose për të hyrë në tregun e punës me një profil profesional të qartë.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet këtij programi është ajo e specialistit në administrim publik. Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi analitike, menaxheriale dhe komunikimi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin institucional, publik apo ndërsektorial në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të politikave publike, menaxhimit të burimeve njerëzore, financave publike, të drejtës administrative, etikës në administratë, etj.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm** (*Hyrje në ekonomi, Historia e ekonomisë, Bazat e marketingut, Hyrje në shkencat politike, Mikroekonomi, Statistikë*) **Kredite 36 ECTS**
2. **Lëndë të formimit karakterizues** (*Bazat e financës, Makroekonomi, Parimet e kontabilitetit, Kontabiliteti financiar, Manaxhimi i burimeve njerëzore, Siguria e Informacionit në Administratën Publike, Manaxhimi strategjik, Financa publike, Baza të Etikës në Administratën Publike, Administrimi i sektorit public, Bazat e qeverisjes, Manaxhimi i ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, Drejtim financiar, Kontabilitet Publik. Sjellje organizative , E drejta administrative dhe kushtetuese*) **Kredite 99 ECTS**
3. **Lëndë integruese** (*E drejtë publike, Matematikë e aplikuar ne shkencat sociale*) **Kredite 13 ECTS**
4. **Lëndë me zgjedhje** (*Komunikimi, Shkrim dhe menaxhim Projektsh, Menaxhim i Biznesit të Vogel, Shkrim Akademik; Drejtim Marketing, Investime, Financa personale; Kontabilitet Drejtimi, Kontabilitet nacional, Kontabilitet i Shoqërive të Sigurimit*) **Kredite 15 ECTS**
5. **Lëndë të formimit plotësues** (*Gjuhë e Huaj (Anglisht, Frengjisht, Italisht); Informatikë, Praktike Profesionale*) **Kredite 10 ECTS**
6. *Përgatitje punim diplome* **Kredite 7 ECTS**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45-54 pikë
6 (gjashtë)	55-64 pikë
7 (shtatë)	65-74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të parë “Bachelor” në Administrim Publik është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt cikleve më të larta të studimit. Kurrikula jonë “Bachelor” në Administrim Publik është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë e një tregu pune dinamik, të globalizuar dhe gjithnjë në transformim, veçanërisht në sektorin publik dhe në fushat ndërdisiplinore që lidhen me të.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit “Bachelor” në Administrim Publik mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të dytë në Administrim Publik, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Menaxhim strategjik, apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë.

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë, ekspertë dhe mësues të profilizuar në fushën e administrimit publik, të politikave publike, menaxhimit të institucioneve publike dhe shërbimeve administrative, të kualifikuar me njohuri të tilla si menaxhimi i burimeve njerëzore, hartimi dhe zbatimi i politikave publike, e-qeverisja, të drejtat administrative dhe transparenca institucionale. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit Bachelor në Administrim Publik është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Institucione të administratës publike qendrore dhe vendore
2. Agjenci rregullatore dhe ente publike
3. Organizata ndërkombëtare
4. Organizata jofitimprurëse
5. Sektorin akademik, kërkues ose konsulencën profesionale në administrim dhe politika publike.

Studentët të cilët përfundojnë programin e studimit “Bachelor” në Administrim Publik fitojnë njohuri në fushat kyçe të funksionimit të administratës publike, përfshirë proceset vendimmarrëse, menaxhimin e projekteve publike, përdorimin e teknologjive moderne në qeverisje, si dhe zhvillimin e aftësive ndërpersonale dhe analitike të nevojshme për të kontribuar në përmirësimin e institucioneve publike dhe ofrimin efektiv të shërbimeve për qytetarët.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (*plani mësimor*)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në ekonomi	6	60	1
2.	Historia e ekonomisë	5	45	1
3.	E drejtë publike	6	60	2
4.	Bazat e marketingut	6	60	1
5.	Hyrje në shkencat politike	6	60	1
6.	Matematikë e aplikuar në shkencat sociale	7	75	2
7.	Bazat e financës	6	60	2
8.	Mikroekonomi	6	60	1
9.	Gjuhe e Huaj (Anglisht, Frengjisht, Italisht)	5	60	2
10.	Statistikë	7	75	2
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	615	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Makroekonomi	7	75	1
2.	Parimet e kontabilitetit	6	60	1
3.	Kontabiliteti financiar	7	75	2
4.	Manaxhimi i burimeve njerëzore	6	60	1
5.	Siguria e Inf. Ne Admin. Publike	6	60	1
6.	Manaxhimi strategjik	6	60	2
7.	Financa publike	6	60	2
8.	Etika ne Administraten Publike	6	60	2
9.	Informatikë	5	45	1
Lëndë me zgjedhje				
10.	-Komunikimi	5	45	2
	-Shkrim dhe menaxhim Projektesh	5	45	2
	-Menaxhim i Biznesit të Vogel	5	45	2
	-Shkrim Akademik	5	45	2
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	600	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Administrimi i sektorit publik	6	60	2
2.	Bazat e qeverisjes	6	60	1
3.	Manaxhimi i ndërmarrjeve dhe institucioneve publike	6	60	2
4.	Drejt看 financiar	7	75	1
5.	Kontabilitet Publik	6	60	2
6.	Sjellje organizative	6	60	1
7.	E drejta administrative dhe kushtetuese	6	60	2
8.	Lëndë me zgjedhje			
	- Drejt看 Marketing	5	45	2
	- Investime	5	45	2
	- Financa personale	5	45	2
9.	Lëndë me zgjedhje			
	- Kontabilitet drejtimi	5	45	1
	- Kontabilitet nacional	5	45	1
	- Kontabilitet i Shoqërive të Sigurimit	5	45	1
10.	Provim formimi/Punim diplome	7	50	2
	Gjithësej viti i tretë	60 ECTS	575	
	Total : viti I + viti II + viti III	180 ECTS		